



YOUNG

Pikëpamjet e rinisë për të ardhmen e Kosovës

27 qershor, 2019
Emerald Hotel

EULEX-i tregon përkushtim afatgjatë për promovimin e rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve të Kosovës. Sundimi i ligjit mbështetet në masë të madhe të shkallë e përfshirjes së të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë. Nëse garantohet sistematikisht, përfshirja dhe përfaqësimi korrespondojnë me mirëqenien dhe prosperitetin e qëndrueshëm të institucioneve demokratike. Meqë rinia pa dyshim se e përfaqëson të ardhmen e Kosovës, dëshirat, aspiratat dhe projektet e të rinjve janë me rëndësi tejet të madhe. Meqë të rinjtë kanë nevoja dhe interesa specifike, ata kanë nevojë për politika të shënjestruara, si dhe për institucionet - para së gjithash në sektorin e sundimit të ligjit - që mundësojnë pjesëmarrjen e tyre dhe iu përgjigjen kërkesave të tyre. Në të vërtetë, autoritetet e Kosovës kanë treguar përkrahje për këtë perspektivë, duke e përfshirë rininë si një nga fushat e ndërhyrjes të dobishme për rritjen e Kosovës. EULEX-i është më se i gatshëm të mbështesë më tej këtë proces, duke krijuar forume të diskutimit mes qytetarëve të rinj të Kosovës dhe duke i dhënë energji debatit mbi kërkesat dhe propozimet e rinisë kosovare.

Si në shumë vende të tjera anembanë botës, kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e lirë dhe të barabartë politike dhe publike, mundësitë për punë ligjore dhe të dinjitetshme, dhe për qasjen e plotë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, qytetarët e Kosovës ende ballafaqohen me një sërë sfidash.

Nëse kjo është e vërtetë për popullatën e përgjithshme, gratë, përveç kësaj, vuajnë forma dytësore të diskriminimit. Pasi që ato janë të nënperfaqësuara në nivelin lokal si dhe qendror politik, niveli i tyre i përfaqësimit në institucionet e sundimit të ligjit, si p.sh. në polici, prokurori dhe gjykata, gjithashtu duhet të rritet, pas përpjekjeve të fundit dhe të lavdërueshme në këtë drejtim nga ana e autoriteteve kosovare. Gratë gjithashtu kanë prona drastikisht më pak sesa burrat, dhe kanë më pak gjasa të punësohen ose të kenë biznese. Ndonëse liritë e tyre zyrtare janë sanksionuar dhe mbrojtur me Kushtetutë dhe në një numër ligjesh të Kosovës, mbetet esenciale që të sigurohet që ky legjislacion të zbatohet plotësisht dhe në mënyrë sistematike.

Në këtë kontekst, të rinjtë në përgjithësi, dhe në këtë mënyrë femrat e reja në veçanti, përballen me një shtresë të tretë të përjashtimit dhe diskriminimit. Për shembull, nëse shkalla e papunësisë në mesin e grave në Kosovë është 37%, ajo pothuajse dyfishohet kur është fjala për femrat e reja. Nga fakti se Kosova ka një nga popullatat më të reja në Evropë dhe ende vuan nga një trashëgimi e ndërlikuar nga e kaluara e saj e afërt, duhet urgjentisht të kushtohet vëmendje e veçantë për të gjetur mënyra për të mundësuar më shumë hapësirë për angazhimin kuptimplotë të brezave të rinj në jetën publike dhe për më shumë mundësi të barabarta.

Veçanërisht duke pasur parasysh se Kosova duket të jetë duke ndjekur një trend më të gjerë kontinental të nën-përfaqësimit të të rinjve në vendimmarrje, dhe vazhdon të ketë kapacitet të kufizuara për përfshirje të plotë dhe për t'iu përgjigjur pozitivisht kontributeve dhe nevojave të qytetarëve të rinj.

Shpeshherë konflikti në njëfarë mënyre e zbehë shoqërinë, destabilizon rolet tradicionale shoqërore dhe dobëson institucionet, duke krijuar kështu mundësi për praninë e njëkohshme brenda një shoqërie si të tipareve konservatore, ashtu edhe të narrativave dhe paradigmave kontradiktore, moderne. Rinia është në mënyrë të pashmangshme në qendër, nëse jo në vijën e parë të këtij procesi - dhe Kosova nuk është përjashtim. Megjithatë, meqë bashkësia ndërkombëtare mbështetë autoritetet e vendit dhe ato rajonale për të ndjekur një rrugë të paqes dhe negocimit, duhet kushtuar më shumë vëmendje rolit të të rinjve, në mënyrë për të mos përforcuar idenë se ata që janë më të përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve aktuale dhe të ardhshme janë vetëm ata që aktualisht kanë qasje në pjesëmarrjen politike dhe në procesin e vendimmarrjes. Sidoqoftë, mbështetja e fortë dhe e vazhdueshme nga ana e rinisë kosovare për institucionet tradicionale siç është familja dhe feja vazhdon në bazë të disa faktorëve, duke përfshirë vlerat shoqërore afatgjata, por edhe pasigurinë socio-ekonomike. Kjo shtron pyetjen se si të rinjtë po përjetojnë, dhe potencialisht riinterpretojnë, këto institucione, dhe se si konservatorizmi dhe inovacioni i të rinjve kombinohen për të sjellë një projekt politik që sheh nga e ardhmja për Kosovën.

Nëse Kosova do të promovojë zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse, të barabartë, multietnike dhe bashkëkohore, ata që do të jetojnë këtë shoqëri dhe ata që tashmë jetojnë dhe përjetojnë këtë kombinim të besimeve inovative dhe paradigmave shoqërore më tradicionale duhet të jenë të angazhuar plotësisht. Për më tepër, gjersa komuniteti vendor dhe ndërkombëtar diskutojnë rolin e Kosovës brenda komunitetit evropian më të gjerë dhe ata punojnë së bashku për të sjellë në Kosovë vlerat dhe praktikat më të mira evropiane, ia vlen të ngiten disa pyetje kyçe. Çfarë do të thotë të jesh kosovar brenda Evropës? Ndërsa vetë qytetarët e BE-së përpiqen të gjejnë pajtim mes identiteteve të tyre kombëtare dhe atij evropian, a mund të flasim ne për një identitet evropian, kosovar? Cili është roli i të rinjve në avancimin e një kuptimi bashkëkohor, evropian të shoqërisë së tyre? Çfarë mund të sjellë Evropa si shembull i frytshëm i integritit midis identiteteve kombëtare dhe evropiane, si mënyrë për të nxitur një kuptim gjithëpërfshirës, egalitar dhe bashkëkohor të shoqërisë? Në vitin 2019, cka nënkupton të jesh i ri, e re, evropiane, kosovare?

Projekti përbëhet prej një eventi njëditor që do të mbahet në Prishtinë. Ai synon të nxisë një debat të lirë dhe konstruktiv me një fokus të veçantë në perspektivën e të rinjve. Ky event dëshiron të jetë nga të rinjtë, me të rinjtë, për të rinjtë.

Në mëngjes, do të organizohen dy diskutime interaktive në panel për të adresuar pyetjet e mësipërme. Do të ketë pjesëmarrje të përfaqësuesve të shoqërisë civile vendore të angazhuar në fuqizimin dhe përfaqësimin e të rinjve, me një vëmendje të veçantë për fuqizimin e grave. Pjesëmarrja e delegatëve të rinj italian të Kombeve të Bashkuara do të shtojë një perspektivë ndërkombëtare në këtë event. Pasi që RKS KB 1325 njih rëndësinë e grave në shoqëritë e pasluftës për rivendosjen dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, RKS KB 2250 njih rolin vendimtar të të rinjve në të njëjtën fushë. Së bashku, ato shtrijnë themelet për përfshirjen e strukturuar dhe të përhershme të grave dhe burrave të rinj për fuqizimin dhe konsolidimin e një shoqërie të qëndrueshme.

Si rezultat i diskutimeve në panel, pjesëmarrësit - përkatësisht qytetarët e rinj të Kosovës - do

të hartojnë një sërë gjetjesh dhe rekomandimesh në bashkëpunim me nikoqirët, që do të shpërndahen në media dhe të dërgohen te autoritetet kompetente vendore dhe ndërkombëtar

Në këtë konferencë njëditore do të jenë të pranishëm:

1. 45 kosovarë të ri, djem dhe vajza të reja;
2. 10 panelistë, përfshirë dy delegatë të rinj të Italisë në KB.

Konferenca do të mbahet në gjuhën angleze.